

VENDIM
Nr. 906, datë 11.11.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E FINANCIVE, PËR ORGANIZIMIN E LOJËS PROMOCIONALE
“LOJA E KUPONIT TATIMOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh, për shpenzime korrente, në programin “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Fondi i përmendur në pikën 1 të përdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për përballimin e shpenzimeve administrative dhe çmimeve fituese të lojës promovionale, të quajtur “Loja e kuponit tatimor”, që do të organizohet nga data 15.11.2015–31.12.2015, në kuadër të nismës kundër informalitetit.

4. Rregullat e organizimit e të funksionimit të lojës, kategoritë e përfituesve, masa e përfitimit për çdo kategori dhe specifikime të tjera për këtë lojë rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për lojërat e fatit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama